



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.39

2005

6 qershor

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9379 datë 28.4.2005	Për efijencën e energjisë 1411
Vendim i Kuvendit nr.186, datë 12.5.2005	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit..... 1416
Vendim i Kuvendit nr.188, datë 19.5.2005	Për ngritjen e kompleksit të ri parlamentar..... 1417
Vendim i Kuvendit nr.189, datë 19.5.2005	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.88, datë 8.9.2003 të Kuvendit të Shqipërisë "Për miratimin e numrit të punonjësve dhe pagave të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive"..... 1417
Vendim i Kuvendit nr.190, datë 20.5.2005	Për shpërndarjen e Legjislaturës XVI të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë..... 1418
Rezolutë e Kuvendit	Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2004..... 1419

Dekret nr.4577 datë 26.5.2005	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare	1420
Vendim i KM nr.387, datë 31.5.2005	Për kalimin e përgjegjësive së administrimit të objekteve të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, nga Ministria e Shëndetësisë Ministrisë së Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit Gjyqësor, zyra e përmbarimit, Vlorë.....	1421
Urdhër i KM nr.63, datë 27.5.2005	Për krijimin e grupit qendror për monitorimin e zbatimit të reformës, për heqjen e pengesave administrative, në fushën e investimeve	1423
Vendim i ERE nr.25, datë 27.5.2005	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.26, datë 13.5.2004 të bordit të komisionerëve të Ere-s “Rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s”.....	1425
	Shpallje kërkesë për shpronësim me objekt shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private (tokë arë), për ndërtimin e ujësjellësit të fshatit Shelegar në qytetin e Sarandës.....	1427
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Stalin Konomi	1427
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasës Mirela Nasi	1427

LIGJ
Nr. 9379, datë 28.4.2005

PËR EFIÇENCËN E ENERGISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është hartimi i kuadrit ligjor të nevojshëm për nxitjen dhe përmirësimin e efijencës së përdorimit të energjisë gjatë gjithë ciklit.

Neni 2
Objekti

Ky ligj përcakton mënyrën e përdorimit ekonomik të burimeve të energjisë, krijimin e kushteve të qëndrueshme të furnizimit me energji, si dhe uljen e ndikimit të dëmshëm në mjedis.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. “Efijenca e përdorimit të energjisë” është raporti në përqindje i energjisë në dalje me energjinë në hyrje, në të njëjtin sistem energjetik.
2. “Ministri” është Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës ose ministri përgjegjës për energjinë.
3. “Agjencia Kombëtare e Energjisë” është struktura përkatëse e ngritur sipas legjislacionit në fuqi.
4. “Konsumator i madh i energjisë” është konsumatori që ka konsum vjetor të energjisë më të madh se 1 GWh energji elektrike dhe/ose 36 toe qymyr dhe/ose 150 tonë nënprodukte nafte dhe/ose 100 000 m³ N gaz natyror dhe/ose që e ka konsumin e përgjithshëm të energjisë më shumë se 36 toe.
5. “Zyra vendore e energjisë” është struktura që merret me çështjet e efijencës së energjisë, në varësi të Agjencisë Kombëtare të Energjisë (AKE).
6. “Fondi i Efijencës së Energjisë” është fondi i krijuar sipas nenit 10 të këtij ligji, për financimin e programeve të efijencës dhe të ruajtjes së energjisë.
7. “Energji” është çdo burim primar energjetik: nafta dhe nënproduktet e saj, gazi natyror, qymyri, drutë e zjarrit, hidroenergji, biomasat, energjia diellore, energjia e erës, energjia gjeotermike, energjia nga mbetjet urbane, si dhe energjitë dytësore elektrike dhe termike.

8. “Ruajtje energjie” është ulja e përdorimit të energjisë, por duke përbushur të njëjtat nevoja.

9. “Impiantet e energjisë” janë tërësia e pajisjeve teknike, që prodhojnë dhe/ose konsumojnë energji.

10. “Auditim energjie” është veprimtaria, me anë të së cilës realizohet kontrolli dhe verifikimi i konsumit dhe i nivelit të efikasitetit të energjisë, në secilin sistem energjetik.

11. “Auditues energjie” është personi fizik ose juridik i licencuar për të realizuar auditimin e energjisë.

12. “Siguruesi i shërbimit për konservimin e energjisë (ESCO)” është personi fizik ose juridik i licencuar, që merret me zbatimin e masave për rritjen e efikasitetit të energjisë.

KREU II POLITIKA E EFIÇENCËS SË ENERGJISË

Neni 4

Objektivat e nxitjes së efikasitetit të energjisë

Objektivat e politikës për përdorimin me efikasitet të energjisë, si pjesë përbërëse e gjithë politikës së energjisë, kanë të bëjnë, kryesisht, me rritjen e sigurisë së furnizimit me energji, nëpërmjet uljes të konsumit të burimeve energjetike dhe të ndotjes së mjedisit.

Arritja e këtij objekti realizohet nëpërmjet:

- a) nxitjes së efikasitetit të energjisë dhe investimeve;
- b) nxitjes së zgjidhjeve financiare për nismat, që synojnë efikasitetin e energjisë;
- c) sigurimit të bashkëpunimit ndërmjet konsumatorëve, prodhuesve, furnizuesve të energjisë dhe autoriteteve publike e private, për të arritur objektivat e efikasitetit të energjisë, të përcaktuara në programin kombëtar për efikasitetin e energjisë;
- ç) mbështetjes së kërkimeve në fushën e efikasitetit të energjisë;
- d) detyrimit të konsumatorëve të energjisë, për nevojën dhe për përfitimet e uljes së konsumit jo të frytshëm dhe joekonomik të energjisë, sipas zgjidhjeve teknike që do t'i japë audituesi i energjisë;
- dh) nxitjes së nismave private për zhvillimin e shërbimeve të ruajtjes së energjisë;
- e) detyrimit të konsumatorëve të mëdhenj për zbatimin e masave për reduktimin e konsumit joeficient, sipas zgjidhjeve teknike që do të japë raporti i auditimit të energjisë.
- ë) bashkëpunimit me vende të tjera në fushën e efikasitetit të energjisë dhe respektimit të traktateve dhe konventave ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 5

Programi kombëtar për efikasitetin e energjisë

Ministri çdo dy vjet paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave një program kombëtar për efikasitetin e energjisë. Në program përfshihet vlerësimi i hollësishëm ekonomik i kursimeve të mundshme dhe financiare të energjisë, i hartuar nga Agjencia Kombëtare e Energjisë.

Neni 6

Zyrat vendore të energjisë

1. Në çdo qark, me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit, ngrihen zyrat vendore të energjisë, të cilat janë në varësi të Agjencisë Kombëtare të Energjisë.

2. Zyrat vendore të energjisë krijojnë dhe përditësojnë bazën e të dhënave të konsumit dhe të burimeve të mundshme të energjisë në nivel vendor, në zbatim të monitorimit të programit kombëtar për efikasitetin e energjisë.

3. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë janë të detyruar të paraqesin, jo më vonë se data 31 mars e çdo viti, në zyrën vendore të energjisë, të vendosur në zonën e tyre, raportin për konsumin e energjisë për vitin e fundit.

4. Konsumatorët e tjerë të energjisë janë të detyruar të paraqesin, jo më vonë se data 31 mars e çdo viti, në zyrën vendore të energjisë, të vendosur në zonën e tyre, raportin për konsumin e tyre aktual të energjisë, vetëm nëse kërkohet.

5. Për sektorët rezidencialë, bujqësorë dhe të transportit zyrtar vendore të energjisë kryejnë vëzhgime për mbledhjen e të dhënave për konsumin e energjisë. Këta konsumatorë janë të detyruar të paraqesin, jo më vonë se data 31 mars e çdo viti, në zyrën vendore të energjisë, të vendosur në zonën e tyre, raportin për konsumin e energjisë për vitin e fundit.

6. Ministri miraton një rregullore për përmbajtjen dhe mënyrën e paraqitjes së raporteve të energjisë nga furnizuesit e lëndës djegëse, furnizuesit e energjisë elektrike dhe nga konsumatorët e energjisë, sipas këtij neni.

Neni 7

Etiketimi i pajisjeve, që konsumojnë energji elektrike

1. Çdo person juridik ose fizik, që prodhon ose importon pajisje elektrike shtëpiake, nuk mund t'i shesë ato, pa plotësuar standardet dhe pa siguruar etiketat e energjisë për këto pajisje. Të dhënat në etiketë duhet të jenë në gjuhën shqipe.

2. Procedurat e standardizimit për pajisjet elektroshtëpiake përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Në etiketë shënohen të dhënat për konsumin specifik të energjisë së pajisjes elektrike, efikasitetin e energjisë, në vlerat më të ulëta dhe më të larta të saj për llojin e pajisjes elektrike, si dhe për ndikimet negative, që mund të shkaktohen nga vënia në përdorim e pajisjes, mbi mjedisin dhe shëndetin e njerëzve.

4. Etiketa vendoset në mënyrë të dukshme mbi pajisjet.

5. Prodhuesi ose importuesi i këtyre pajisjeve është përgjegjës për saktësinë e të dhënave në etiketë.

6. Procedurat për etiketimin e pajisjeve elektroshtëpiake përcaktohen në një rregullore, të miratuar nga ministri.

7. Kontrolli i etiketimit të pajisjeve, që konsumojnë energji elektrike, kryhet nga organet e specializuara, sipas ligjeve në fuqi.

KREU III

AUDITIMI I ENERGJISË

Neni 8

Detyrat e audituesit të energjisë dhe të subjekteve që auditohen

1. Audituesi i energjisë e ushtron veprimtarinë në përputhje me këtë ligj.

2. Audituesi i energjisë kryen matjen e saktë të nivelit të konsumit specifik të impianteve të energjisë, për rritjen e efikasitetit të tyre.

3. Auditimi i energjisë pasqyrohet në një raport me shkrim që përmban:

a) vlerësimin e nivelit të konsumit të energjisë në impiantet përkatëse;

b) propozimin për masat që duhen zbatuar për ruajtjen e energjisë, përfshirë analizën e tyre ekonomike;

c) mendimin përfundimtar të audituesit të energjisë, për mundësitë për rritjen e efikasitetit të energjisë, si dhe të zgjidhjes teknike përkatëse.

4. Audituesi i paraqet një kopje të raportit të auditimit të energjisë, si dhe të zgjidhjes teknike Agjencisë Kombëtare të Energjisë dhe zyrës vendore të energjisë, për subjektet për të cilat auditimi është i detyrueshëm ose kur auditimi është financuar nga Fondi për Eficiencën e Energjisë.

5. Auditimi i energjisë është i detyrueshëm për:

a) personat fizikë ose juridikë, që aplikojnë për financim nga Fondi për Eficiencën e Energjisë;

b) institucionet shtetërore ose shoqëritë, që janë konsumatorë të mëdhenj të energjisë dhe janë, tërësisht ose pjesërisht, të financuar nga Buxheti i Shtetit;

c) personat fizikë ose juridikë, që nuk janë përfshirë në shkronjën “b” të kësaj pike, me konsum të përgjithshëm vjetor energjie më të madh se 1 GWh energji elektrike dhe/ose 36 toe qymyr dhe/ose 150 tonë nënprodukte naftë dhe/ose 100 000 m³ N gaz natyror dhe/ose që e kanë konsumin e përgjithshëm të energjisë më shumë se 36 toe.

6. Auditimet e detyrueshme të energjisë, për subjektet e përcaktuara në pikën 5 të këtij neni, kryhen çdo tre 3 vjet dhe çdo herë para vënies në punë të çdo objekti.

7. Personat fizikë ose juridikë, subjekte të auditimeve të energjisë, i mbulojnë vetë shpenzimet e auditimit dhe të realizimit të zgjidhjeve teknike që jep audituesi për kursimin dhe konservimin e energjisë.

8. Përmbajtja e hollësishme e raportit të auditimit të energjisë përcaktohet me rregullore, të miratuar nga ministri.

Neni 9

Licencimi i audituesit të energjisë

1. Audituesi i energjisë licencohet nga ministri.

2. Personi licencohet si auditues energjie, kur:

a) ka kryer arsimin e lartë për shkencat teknike në fushën e energjisë dhe ka një përvojë pune 5-vjeçare në shfrytëzimin e energjisë ose ka kryer një kurs trajnimi të njohur për teknikat e auditimit;

b) nuk është dënuar për vepra penale, të kryera në lidhje me ushtrimin e detyrës;

c) ka kaluar testimin e ekspertit, sipas pikës 3 të këtij neni.

3. Testimi i ekspertit kryhet para një bordi testues, anëtarët e të cilit emërohen nga Kryetari i AKE-së. Numri i anëtarëve të bordit testues, veprimtaria dhe shpërblimi i tyre përcaktohen me rregullore, që miratohet nga ministri.

4. Aplikimi për licencë për auditim energjie paraqitet me shkrim në AKE. Forma e aplikimit përcaktohet me rregullore, e cila miratohet nga ministri.

5. Aplikimit për licencë për auditim energjie, sipas pikës 4 të këtij neni, i bashkëlidhen dokumentet e mëposhtme:

a) diploma e shkollës së lartë për shkencat teknike ose ekonomike;

b) dëshmia e penalitetit, e lëshuar jo më parë se tre muaj nga data e aplikimit;

c) vërtetim për përvojë pune pesëvjeçare në fushën e shfrytëzimit të energjisë dhe dëshmia e kursit të trajnimit për auditim;

ç) certifikatë e testimit të ekspertit të AKE-së;

6. Audituesi i energjisë është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e të gjitha të dhënave për personin fizik ose juridik dhe për impiantet, të cilat kanë qenë objekt i auditimit të energjisë. Audituesi i energjisë nuk duhet të përfitojë në asnjë mënyrë nga këto të dhëna dhe nuk duhet t'i përdorë ato në favor ose në dëm të një pale të tretë. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit shuhet vetëm pas miratimit nga personat fizikë ose juridikë, impiantet e të cilëve kanë qenë objekte të auditimit të energjisë ose kur kjo parashikohet me ligj.

KREU IV
FONDI PËR EFIÇENCËN E ENERGISË

Neni 10

Ngritja dhe financimi i fondit

Burimet financiare për realizimin e programit kombëtar të efijencës së energjisë, të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji, janë:

1. Fondi i krijuar nga Këshilli i Ministrave, i cili përdoret vetëm për efijencën dhe ruajtjen e energjisë.
2. Fondi për Efijencën e Energjisë, i cili mund të financohet nga:
 - a) fondet vjetore të Buxhetit të Shtetit, të planifikuara për ministrinë përgjegjëse për energjinë, të cilat duhet të përdoren brenda vitit buxhetor;
 - b) grantet e burimeve ndërkombëtare financiare;
 - c) burimet private;
 - ç) fondi i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike, në ato raste kur Enti vendos të zbatojë programet e ruajtjes së energjisë, sipas neneve 8 pika 2 shkronja “e” dhe 28 pika 2 shkronja “gj” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, për kategori të ndryshme konsumatorësh të energjisë.

Fondet e pashpenzuara në një vit fiskal mbeten për t’u përdorur për programet e ardhshme të efijencës dhe të ruajtjes së energjisë.

Neni 11

Administrimi i Fondit për Efijencën e Energjisë

1. Administrimi i Fondit për Efijencën e Energjisë, të krijuar sipas nenit 10 të këtij ligji, bëhet nga Agjencia Kombëtare e Energjisë, e cila kërkon dhe përcakton shpërndarjen e programeve të zbatimit për efijencën e energjisë në të gjitha rajonet e vendit.

2. Ministri miraton për programet e efijencës së energjisë, kontratat me siguresit e shërbimit të konservimit të energjisë, sipas pikës 3 të këtij neni.

3. Ministri, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Energjisë, zgjedh siguresit e shërbimit të konservimit të energjisë, pas një procesi konkurrues tenderimi, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 12

Veprimtaritë dhe programet e financuara nga Fondi për Efijencën e Energjisë

Fondi për Efijencën e Energjisë përdoret për financimin e këtyre veprimtarive:

- a) investimeve, që synojnë përmirësimin e efijencës së energjisë në ndërtesa publike dhe private, në ndërmarrje industriale dhe në sektorin e transportit;
- b) investimeve, që synojnë përmirësimin e efijencës së energjisë në nxjerrjen, prodhimin dhe transportin ose transmetimin e energjisë;
- c) veprimtarive të kërkimit dhe të zhvillimit për rritjen e efijencës së energjisë;
- ç) hartimit të projekteve demonstruese, me qëllim kërkimin dhe testimin e teknologjive të reja ose gjetjen e zgjidhjeve të reja organizative për sektorin e energjisë;
- d) auditimeve të energjisë, sipas nenit 8 të këtij ligji.

KREU V
DISPOZITA TË TJERA

Neni 13
Sanksionet

1. Çdo person, që nuk ka raportuar ose që ka paraqitur një raport të rremë, që nuk është në përputhje me dispozitat e pikës 3 të nenit 6 të këtij ligji, kryen kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet nga zyra vendore e energjisë, e vendosur në zonën e tij, me gjobë 100 000 lekë.

2. Çdo person, që nuk ka raportuar ose që ka paraqitur një raport të rremë, që nuk është në përputhje me dispozitat e pikës 4 të nenit 6 të këtij ligji, kryen kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet nga zyra vendore e energjisë, e vendosur në zonën e tij, me gjobë 50 000 lekë.

3. Çdo person që pas kërkesës nuk ka raportuar ose që ka paraqitur një raport të rremë, që nuk është në përputhje me dispozitat e pikës 5 të nenit 6 të këtij ligji, kryen kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet nga zyra vendore e energjisë, e vendosur në zonën e tij, me gjobë 5 000 lekë.

4. Çdo person që shkel dispozitat e nenit 7 të këtij ligji, gjobitet nga Inspektorati i Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike me gjobë 100 000 lekë.

5. Gjobat e vendosura sipas pikave 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4571, datë 12.5.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

VENDIM
Nr. 186, datë 12.5.2005

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS
DHE TELEVISIONIT**

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Albert Minga zgjidhet në detyrën e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT).

II. Ky vendim hyn në fuqi në datën 30.6.2005.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr. 188, datë 19.5.2005

PËR NGRITJEN E KOMPLEKSIT TË RI PARLAMENTAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, me propozim të Kryetarit të Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ndërtimin e Kompleksit të ri Parlamentar në shërbim të veprimtarisë së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, sipas Detyrës së Projektimit bashkëngjitur këtij vendimi, në sheshin e ndërtimit të përcaktuar sipas Vendimit të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.

II. Projekti i Kompleksit të ri Parlamentar realizohet me anë të konkursit ndërkombëtar.

III. Kompleksi Parlamentar ndërtohet për një periudhë deri në pesë vjet nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Buxheti i Kuvendit planifikon, vit pas viti, fondet e nevojshme, sipas grafikëve të punimeve.

IV. Për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi krijohet një Komision i Posaçëm Shtetëror, i përbërë nga:

- Kryetari i Kuvendit;
- Kryetari i Këshillit të Ministrave;
- Ministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit;
- Ministri i Financave;
- Kryetari i Bashkisë së Tiranës;
- Kryetarët e dy grupeve më të mëdha parlamentare në Kuvend;
- Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

V. Pranë Komisionit të Posaçëm Shtetëror ngrihet një sekretari teknike për ndihmë dhe asistencë të këtij Komisioni.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr. 189, datë 19.5.2005

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.88, DATË 8.9.2003 TË
KUVENDIT TË SHQIPËRISË "PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE
PAGAVE TË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURIVE"

Në mbështetje të nenit 16 pika 4 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", dhe të nenit 88 të rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin nr.88, datë 8.9.2003 të Kuvendit të Shqipërisë, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- I. Në pikën I, fjalët "prej 30 vetësh" zëvendësohen me fjalët "prej 35 vetësh".
- II. Në tabelën e pagave të punonjësve të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me emërtimin "specialist", me pagë sipas kategorisë IV-a.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr. 190, datë 20.5.2005

**PËR SHPËRNDARJEN E LEGJISLATURËS XVI TË KUVENDIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 65 dhe 78 të Kushtetutës, si dhe të nenit 7 pika 3 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Shpërndarja e Legjislaturës XVI të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për efekt të zgjedhjeve për Kuvendin e ri, bëhet në datën 20 maj 2005.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2004

Pasi u njoh me Raportin për Veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë për Vitin 2004, bazuar në nenin 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit,

Kuvendi konstaton se:

Veprimtaria e Bankës së Shqipërisë është në përputhje me kërkesat e nenit 161 të Kushtetutës dhe me ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.8384, datë 29.7.1998 "Për shtimin e një dispozite tranzitore në ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë".

Kuvendi i Shqipërisë,

Vlerëson si të suksesshme veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë nisur nga rezultatet konkrete që ky institucion ka pasur gjatë vitit të kaluar. Në përputhje me objektivat e vënë që në fillim të vitit, ndryshimi 12-mujor i indeksit të çmimeve të konsumit regjistroi vlerën 2,1 për qind, duke qenë brenda intervalit objektiv 2-4 për qind. Objektivat e ndërmjetëm të programit monetar, pjesë e kushtëzimeve të marrëveshjes së nënshkruar nga ana e autoriteteve shqiptare me FMN-në, janë përmbushur në mënyrë të kënaqshme. Sistemi bankar u zgjerua më tej gjatë vitit të kaluar, ndërkohë që vazhdoi konsolidimi i mëtejshëm i tij. Zhvillime pozitive janë regjistruar në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës së pagesave, si dhe në drejtim të reduktimit të përdorimit të parasë cash në ekonomi.

Kuvendi i Shqipërisë inkurajon Bankën e Shqipërisë në të gjitha nismat e saj të kohëve të fundit dhe shpreh bindjen se ajo do të vazhdojë të konsolidohet më tej si në aspektin institucional, ashtu edhe në atë profesional.

Kuvendi kërkon që për vitin 2005, t'i kushtohet vëmendje më e madhe punës për të:

- forcuar më tej pavarësinë e institucionit në të gjitha përmasat e saj në aspektin institucional, funksional, organizativ dhe financiar;

- rritur më tej besueshmërinë e publikut ndaj saj, nëpërmjet ideimit dhe zbatimit të politikave monetare sa më të përshtatshme dhe sa më transparente, duke rritur më tej shpjegimin e vendimmarrjes së saj politike për arritjen e stabilitetit të çmimeve;

- rritur më tej besueshmërinë e publikut ndaj sistemit bankar, nëpërmjet ushtrimit të standardeve bashkëkohore në fushën e licencimit dhe të mbikëqyrjes bankare;

- rritur më tej bashkëpunimin me institucionet e tjera të rëndësishme, me qëllim harmonizimin sa më të madh të politikës monetare me politikën e tjera ekonomike, veçanërisht me politikën fiskale;

- përmirësuar më tej kushtet që lidhen me financimin e ekonomisë me kredi nga ana e sistemit bankar, duke synuar kryesisht një mbulim sektorial më proporcional, përfshirë dhe prodhimin bujqësor;

- kontribuar në përshpejtimin e integritetit të vendit në fushën e bankave, të financave, të politikave ekonomike, pa përjashtuar edhe përafrimin e kuadrit ligjor, rregullativ dhe të atij operacional me modelet e përparuara të Bashkimit Europian.

Kuvendi i kërkon Bankës së Shqipërisë që të thellojë kontributin e saj pozitiv në drejtim të:

- konsolidimit të mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik të vendit. Për këtë qëllim Banka e Shqipërisë duhet t'u përmbahet angazhimeve të marra në Memorandumin e Politikave Ekonomike, të hartuar në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të miratuar nga Bordi i Drejtorëve të FMN-së në datën 28 shkurt 2005;

- dhënies së ekspertizës në fushën e stabilitetit financiar, duke përbushur në vazhdimësi detyrimin e saj ligjor për të dalë në publik me deklarata për kërcënime ose shqetësime të ndryshme, që karakterizojnë stabilitetin financiar të vendit;

- përbushjes së funksionit të këshilltarit të Qeverisë në lidhje me vendimmarrjen e politikave ekonomike të kësaj të fundit, përfshirë dhe këshillimin në procesin e ideimit, të hartimit dhe të zbatimit të strategjive kombëtare të zhvillimit të vendit;

- studimit të kuadrit ligjor dhe atij rregullator, duke vlerësuar përshtatshmërinë e tij në lidhje me zhvillimet më të fundit nëpër segmente të ndryshme të tregut financiar, duke synuar një gjallërim më të madh të kredisë për ekonominë, të tregut të parasë dhe të atij valutor;

- përfundimit të projektit të kryqëzimit të pagesave në vlerë të vogël dhe të vlerësimit të mundësive për një bashkëpunim të ri me Bankën Botërore në krijimin e Byrosë së Regjistrimit të Kredive;

- përbushjes së të gjitha rekomandimeve që do të rrjedhin nga raporti i ekspertëve të FMN-së dhe BB-së në vlerësimin e fundit që ata i bënë sektorit financiar të vendit (FSAP). Parësore në këtë drejtim mbetet përsosja e mëtejshme e transparencës së politikës monetare dhe ridimensionimi i procesit të llogaridhënies së institucionit.

Kuvendi i kërkon Këshillit të Ministrave që të:

- formulojë qëndrimin e tij në lidhje me të ardhmen e afërt dhe të largët të marrëdhënieve financiare të huadhënies midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave;

- rrisë më shumë bashkëpunimin dhe thithjen e ekspertizës nga ana e Bankës së Shqipërisë.

Në përfundim, Kuvendi i Shqipërisë shpreh besimin e tij se Banka e Shqipërisë, edhe gjatë vitit 2005, do të vazhdojë të jetë një institucion i përgjegjshëm në fushën e hartimit dhe zbatimit të politikave ekonomike dhe të konsolidimit të mëtejshëm të stabilitetit financiar të vendit.

DEKRET

Nr. 4577, datë 26.5.2005

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|--|-------------------------------------|
| 1. Suela Kujtim Zhegu | 20. Elda Ferit Shabani |
| 2. Xhoana Dede Zhegu | 21. Hasan Gzim Shabani (Mehmeti) |
| 3. Ekaterini Filip Fellenberg (Petani) | 22. Ardiana Ahmet Kapidani (Bali) |
| 4. Antonella Heiko Fellenberg | 23. Feride Shaban Enard (Gjongecaj) |
| 5. Erando Muharrem Rustemi | 24. Erika Ndoc Luka (Jakaj) |
| 6. Bajram Shaban Toska | 25. Erhard Tonin Luka |
| 7. Teodor Koçi Stroni | 26. Gon Ram Qelia |
| 8. Armando Bari Zani | 27. Teodor Shyqyri Stafa |
| 9. Dritan Dilaver Karalliu | 28. Ervin Petrit Zela |

10. Oliver Dritan Karalliu
11 .Lorenz Dritan Karalliu
12. Manjola Ilir Karalliu (Hotova)
13. Elisabeta Sali Pleqi (Kacabanaj)
14. Seibi Gerond Alimehmeti
15. Sokol Sherif Vasili
16. Drita Hysen Michaelis (Tanushi)
17. Greta Man Teta (Buci)
18. Cindy-Lucia Adrian Teta
19. Fjoralba Hasan Duka

29. Shaqir Zeqir Matmuja
30. Anila Isuf Agimgostivari (Mesiti)
31. Jaeisi Lulzim Agimgostivari
32. Mehrije Lulzim Agimgostivari
33. Ana Lulzim Agimgostivari
34. Donika Kadri Santo (Zahaj)
35. Lumturie Nexhmedin Osmani
36. Marlend Mustafa Osmani
37. Ermir Muharrem Dautaj
38. Norges Nisi Vangjeli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr. 387, datë 31.5.2005

**PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË OBJEKTEVE TË
INSTITUTIT TË SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR, NGA MINISTRIA E
SHËNDETËSISË MINISTRISË SË DREJTËSISË, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME
TË PËRMBARIMIT GJYQËSOR, ZYRA E PËRMBARIMIT, VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e përgjegjësisë së administrimit të objekteve të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, dega Vlorë, nga Ministria e Shëndetësisë Ministrisë së Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarrimit Gjyqësor, zyra e përmbarrimit, Vlorë, të përcaktuara në formularin nr.1, me numër rendor 1 dhe sipas planimetrisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit Gjyqësor, zyrës së përmbarrimit, Vlorë i ndalohet ta ndryshojë destinacionin, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve pronën e caktuar në këtë vendim.


3. Ngarkohen Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit Gjyqësor dhe kryregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Vlorë

OBJEKTI : PLANIMETRIA E ZYRAVE NE PRONESI TE I.S.K.SH.
ADRESA : Lagjja " Kushtrim ", Rruga " Jonaq Kilica ", pallati nr. 563, shkalla nr.3, kati perdhe



SIPERFAQET E AMBIENTEVE

- AMBIENTI NR ① = 16.2M²
- AMBIENTI NR ② = 16.56M²
- AMBIENTI NR ③ = 10.56M²
- AMBIENTI NR ④ = 10.56M²
- AMBIENTI NR ⑤ = 16.2M²
- AMBIENTI NR ⑥ = 16.2M²
- AMBIENTI NR ⑦ = 11.66M²
- AMBIENTI NR ⑧ = 6.9M²
- AMBIENTI NR ⑨ = 3.45M²
- AMBIENTI NR ⑩ = 3.15M²
- SIP. MURATÛRE = 28.40M²

GJITHSEJTE = 156.04M²

		OBJEKTI	ZYRAT E I.S.K.SH.
PRONAR	I.S.K.SH.	URBANIST	SAMI ÇANA
ARKITEKT	SAMI ÇANA	NR. LICENCA	A-0135
TELETA	PLANIMETRIA	NR. LICENCA	A-0135
VLORE ME 10/09/1999			

URDHËR
Nr. 63, datë 27.5.2005

PËR KRIJIMIN E GRUPIT QENDROR PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË REFORMËS, PËR HEQJEN E PENGESAVE ADMINISTRATIVE, NË FUSHËN E INVESTIMEVE

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 102 të Kushtetutës,

URDHËROJ:

1. Krijimin e grupit qendror për monitorimin e zbatimit të reformës, për heqjen e pengesave administrative, në fushën e investimeve.

2. Ky grup të kryesohet nga Ministri i Ekonomisë dhe në përbërje të ketë:

- Zëvendësministrin e Financave anëtar;
- Zëvendësministrin e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit anëtar;
- Zëvendësministrin e Drejtësisë anëtar;
- Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve anëtar;
- Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave anëtar;
- Nënkryetarin e Bashkisë së Tiranës anëtar;
- Drejtorin e Njësisë Antikorrupsion, pranë Ministrit të Shtetit për Koordinimin anëtar;

3. Grupi qendror ka këto detyra:

i) Të hartojë planveprimin për heqjen e pengesave administrative, në përputhje me rekomandimet e raportit të vetëvlerësimit të Këshillit të Ministrave;

ii) Të drejtojë grupet teknike, sipas fushave të analizuar në raportin e vetëvlerësimit dhe në përputhje me fushën e veprimtarisë;

iii) të drejtojë procesin e vlerësimit dhe të monitorimit të vazhdueshëm të planveprimit;

iv) të raportojë, në mënyrë periodike, pranë Kryeministrit, për ecurinë e procesit.

4. Për realizimin e detyrave të përcaktuara në pikën 3, grupi i punës të mbështetet nga grupet teknike, me këto përbërje:

a) Grupi teknik për sistemin e taksave:

- Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve;
- Një specialist nga Ministria e Ekonomisë;
- Një specialist nga administrata tatimore;
- Një përfaqësues nga Fakulteti Ekonomik;
- Një përfaqësues nga Bashkia e Tiranës;
- Një përfaqësues nga komuniteti i biznesit, anëtar i Këshillit Konsultativ të Biznesit.

b) Grupi teknik për sistemin e doganave

- Drejtori i Përgjithshëm i Doganave;
- Një specialist nga Ministria e Ekonomisë;
- Një specialist nga administrata doganore;
- Një përfaqësues nga Fakulteti Ekonomik;
- Një përfaqësues nga komuniteti i biznesit, anëtar i Këshillit Konsultativ të Biznesit.

c) Grupi teknik për problemet e tokës dhe të lejeve të ndërtimit:

- Zëvendësmministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit;
- Nënkryetari i Bashkisë së Tiranës;
- Një specialist nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit;
- Një specialist nga Ministria e Ekonomisë;
- Një përfaqësues i Bashkia e Tiranës;
- Një përfaqësues nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;

- Një përfaqësues nga Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe i Kompensimit të Pronave;
- Një përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit;
- Një përfaqësues nga komuniteti i biznesit, anëtar i Këshillit Konsultativ të Biznesit;

ç) Grupi teknik për problemet e licencimit:

- Drejtori i Njësisë Antikorrupsion;
- Drejtori i Drejtorisë së Nxitjes së Biznesit, në Ministrinë e Ekonomisë;
- Një specialist nga Ministria e Ekonomisë;
- Një përfaqësues nga Fakulteti Ekonomik;
- Një përfaqësues nga komuniteti i biznesit, anëtar i Këshillit Konsultativ të Biznesit.

d) Grupi teknik për problemet në sistemin administrativ të apelimit:

- Zëvendësministri i Drejtësisë;
- Një specialist nga Ministria e Drejtësisë;
- Një specialist nga Ministria e Ekonomisë;
- Një përfaqësues nga Fakulteti i Drejtësisë;
- Një përfaqësues nga komuniteti i biznesit, anëtar i Këshillit Konsultativ të Biznesit.

dh) grupi teknik për problemet e regjistrimit të biznesit:

- Zëvendësministri i Drejtësisë;
- Një specialist nga Ministria e Drejtësisë;
- Një specialist nga Ministria e Ekonomisë;
- Një specialist nga administrata tatimore;
- Një përfaqësues nga Bashkia e Tiranës;
- Një përfaqësues nga Zyra e Regjistrimit Tregtar;
- Një përfaqësues nga komuniteti i biznesit anëtar i Këshillit Konsultativ të Biznesit.

e) Grupi teknik për problemet e inspektimit të biznesit:

- Drejtori i Drejtorisë së Nxitjes së Biznesit në Ministrinë e Ekonomisë;
- Një specialist nga Ministria e Ekonomisë;
- Një specialist nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;
- Një specialist nga Ministria e Shëndetësisë;
- Një specialist nga administrata tatimore;
- Një përfaqësues nga Bashkia e Tiranës;
- Një përfaqësues nga komuniteti i biznesit, anëtar i Këshillit Konsultativ të Biznesit.

5. Titullarët e ministrive dhe të institucioneve të përmendura në pikat 2 e 4, brenda tre ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të caktojnë përfaqësuesit e tyre në grupin qendror dhe në grupet teknike.

6. Grupi qendror, brenda datës 30 qershor 2005, të paraqesë planin e hollësishëm të veprimit, për miratim në Këshillin e Ministrave.

7. Ngarkohet Drejtorja e Nxitjes së Biznesit, sektori i lehtësimit të tregtisë, në Ministrinë e Ekonomisë, për bashkërendimin e punës ndërmjet grupit qendror dhe grupeve teknike, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të ecurisë së këtij procesi.

8. Urdhri nr.66, datë 6.5.2003 i Kryeministrit “Për krijimin e grupit qendror për hartimin dhe zbatimin e planit të veprimit për heqjen e pengesave administrative në fushën e investimeve”, shfuqizohet.

9. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 25, datë 27.5.2005

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.26, DATË 13.05.2004
TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S “RREGULLAT E PRAKTIKËS
DHE PROCEDURAVE TË ERE-S”**

Në mbështetje të nenit 9 pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të vendimit nr.26, datë 13.5.2004 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s”, neni 37, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.5.2005 pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, për disa shtesa dhe ndryshime në rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s,

VENDOSI:

Në vendimin nr.26 datë 13.5.2004 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s”, të bëhen këto ndryshime:

1. Neni 8 germa A ndryshohet si më poshtë vijon:

A. Përveç problemeve që janë objekt i çështjeve të brendshme të ERE-s, të gjitha mbledhjet, procedimet publike dhe sesionet vendimmarrëse të Bordit do të jenë të hapura për publikun. Si rregull, mbledhjet mbahen në zyrat e ERE-s. Në rast se mbledhjet mbahen në vend tjetër, ky tregohet në njoftimin e mbledhjes. Zhvillimi i mbledhjeve të hapura bëhet sipas një procedure të caktuar në një rregullore të miratuar nga Bordi i Komisionerëve, e cila u bëhet e njohur pjesëmarrësve në momentin e hapjes së mbledhjes nëpërmjet leximit nga sekretarja e Bordit të Komisionerëve.

2. Në nenin 11 bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

A. Pas marrjes së një aplikimi, peticioni, ankese ose kërkesë, Kryetari i ERE-s, brenda 5 (pesë) ditëve ia paraqet Bordit të Komisionerëve për vlerësim. Brenda 7 ditëve Bordi i Komisionerëve do të shprehet për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së aplikimit, peticionit, ankesës ose kërkesës dhe përcakton departamentet përgjegjëse për trajtimin e aplikimit, peticionit, ankesës ose kërkesës.

Nëse departamentet konstatojnë se kërkesat janë plotësuar gjerësisht, por mungojnë disa informacione të kërkuara, në konsultim me kryetarin e Bordit, do të njoftojnë palën kërkuese për sigurimin e informacionit brenda 10 ditëve të rregullta pune. Nëse pala kërkuese siguron informacionin brenda kohës së caktuar, procedimi do të konsiderohet se ka filluar në kohën e kërkesës fillestare.

B. Në germën B) fjala sekretare zëvendësohet me fjalën ERE.

Pas pikës C) shtohet pika D) me përmbajtjen si më poshtë:

D. Në përfundim të afateve sipas tipit të kërkesës për një procedim të nisur, departamentet do të paraqesin në Bord projektvendimin ose një relacion mbi procedurën e ndjekur.

3. Neni 14 germa B) ndryshohet si më poshtë vijon:

B. “Çdo person, përpara se të paraqesë një ankesë në lidhje me një shoqëri shpërndarjeje, duhet të bëjë përpjekje që të zgjidhë mosmarrëveshjen me shoqërinë shpërndarëse, por kjo nuk përbën kusht për të penguar paraqitjen e ankesës në ERE”.

4. Neni 19 pika 4) ndryshohet si më poshtë vijon:

4. Mbas miratimit nga Bordi i Komisionerëve të një rregulli, rregulloreje ose çdo akti tjetër nënligjor sipas pikës 1, ERE do të njoftojë të gjitha palët e prekura që kanë dërguar komente brenda një afati 5 (pesë) ditë të rregullta pune, nëse komentet e tyre janë pranuar ose kundërshtuar.

5. Neni 21 pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:
2. Një shqyrtim paraprak nga ana e Bordit të Komisionerëve të ERE-s i kërkesës formale të paraqitur sipas paragrafit (1) dhe njoftimi i të licencuarit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike, për marrjen ose jo në shqyrtim nga ana e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të aplikimit për tarifë e propozuara.
6. Në nenin 22 shtohet paragrafi me përmbajtjen:
- Çdo aplikues që paraqet në ERE një propozim për vendosjen apo rishikimin e një çmimi apo tarife, duhet të zbatojë metodologjitë përkatëse të miratuara nga ERE për hartimin dhe llogaritjen e çmimeve dhe tarifave. Në mënyrë më specifike, propozimet duhet të shoqërohen nga dokumentet e mëposhtme:
7. Në germën G të nenit 22 shtohet fjalia me përmbajtjen:
- G- e miratuara nga ERE për hartimin dhe llogaritjen e çmimeve dhe tarifave.
8. Neni 23 ndryshohet si më poshtë vijon:
- Çdo paraqitje e tarifave që nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 22 dhe 25 germa A), është një paraqitje e mangët. Brenda 15 ditëve kalendarike nga marrja e propozimit të mangët, ERE duhet të njoftojë aplikuesin për mangësitë dhe nëse propozimi është në përgjithësi në përputhje me kërkesat e nenit 22 dhe 25 germa A) pavarësisht mangësive, ERE mund të lejojë aplikuesin të ndreqë mangësitë, brenda 15 ditëve kalendarike nga dita e njoftimit.
9. Në nenin 25 germa A), në fund të paragrafit të parë, pas fjalëve “duhet të njoftojë” shtohen fjalët me këtë përmbajtje:
- “brenda 5 ditëve nga depozitimi i propozimit”.
10. Në nenin 29, në fund të pikës 5 shtohen fjalët me këtë përmbajtje:
- “kur nuk arrihet mirëkuptimi nga palët në proces, të cilat kërkojnë një vendimmarrje nga ERE” .
11. Germa B e nenit 29 ndryshohet si më poshtë:
- Përveçse kur vendoset ndryshe nga Bordi ose parashikohet ndryshe nga aktet nënligjore të miratuara nga ERE, personi drejtues mund:
12. Neni 33 ndryshohet si më poshtë vijon:
- ERE do t’u dërgojë brenda 5 (pesë) ditëve njoftim me shkrim të gjitha palëve të interesuara për vendimet përfundimtare të Bordit. Teksti i plotë i të gjitha vendimeve përfundimtare, do të vendoset në regjistrin zyrtar të vendimeve dhe licencave dhe do të bëhet i disponueshëm për shqyrtim nga publiku.
13. Neni 35 ndryshohet si më poshtë vijon:
- Vendimet përfundimtare të Bordit të ERE-s mund të ankimohen në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë brenda 30 ditëve nga botimi i vendimit të Bordit në Fletoren Zyrtare.
14. Neni 36 ndryshohet si më poshtë vijon:
- Vendimet e Bordit të ERE-s lidhur me çështjet me interes të gjerë publik, siç përcaktohet nga Bordi, do të dorëzohen nga ERE për publikim në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe në faqen e ERE-s në internet.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit shpall kërkesën “Për shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme, pronë private (tokë arë) për ndërtimin e ujësjellësit të fshatit Shelegar në qytetin e Sarandës”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është bashkia Sarandë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personin i cili preket nga ku shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i shpronësimit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, për pronarin sipas listës emërore të mëposhtme.

PRONARI QË DO TË SHPRONËSOHET NGA NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT TË FSHATIT SHELEGAR, NË QYTETIN E SARANDËS

Nr.	Emri, mbiemri	Sip/tokë are	Çmimi i objektit m ² (lekë)	Vlera në (lekë)
1.	Theodhori Cato	50 m ²	1000	50 000

Vlera totale e shpronësimit është 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Bazuar në nenin 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, vlera e shpenzimeve të procedurës së shpronësimit do të përballohet nga subjekti kërkues i shpronësimit që është bashkia Sarandë.

KËRKESE

Shtetësja Arsino Nushi banuese në Marinëz kërkon shpalljen të vdekur të vëllait të saj, shtetasit Stalin Konomit.

KËRKUESE
Arsino Nushi

KËRKESE

Shtetësja Zoica Nasi banuese në Berat kërkon shpalljen të zhdukur të motrës së saj, shtetases Mirela Nasi.

KËRKUESE
Zoica Nasi

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI:

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 6.6.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi: 150 lekë